

01-1006



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 44 dhe 79 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr. 05/L-031, dt.21.06.2016, nenit 17 pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, dhe nenit 15 pika "d" të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01nr.110-391, dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës 05nr.070/01 – 72633/24 dt.05.06.2024, të kërkuarit: Pronarit, Besim Ajeti nga Prishtina, Lagjja e "Muhaxhirëve", rr."Gazmend Zajmi" p.n., për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimi të kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 238890/22 dt.16.06.2023, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë rregullt për vendosjen e çështje administrative, me datë 21.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

VAZHDIMI I AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUSHTEVE NDËRTIMORE,
05NR.350/02 – 238890/22 DT.14.06.2023

I. I vazhdohet afati i vlefshmërisë, Vendimit të kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 238890/22 dt.14.06.2023, lëshuar nga kjo drejtori, në emër të kërkuarit: Pronarit, Besim Ajeti nga Prishtina, Lagjja e "Muhaxhirëve", rr. "Gazmend Zajmi"p.n., për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesë shumë banesore & afariste – Ndërtesa, me 3B+S+P+8 (me aplikim të arkitekturës së qëndrueshme), në kuadër të Blloku urban "b_06", Nën tërësia "B-1", Tërësia hapësinore "B" të Planit Rregullues "Muhaxhirët" dhe PZHU-së në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale: nr.10564-2 dhe 15064-1 ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit konceptual dhe "zgjidhjes urbane" të prezantuar;

II. Afati i vlefshmërisë së vendimit të kushteve ndërtimore nga paragrafi I. i këtij vendimi, është një (1) vit, dhe i njëjti do të prodhojë efekte juridike nga dita e njoftimit të palës me aktin administrativ.

A r s y e t i m

Kërkuari: Pronari, Besim Ajeti nga Prishtina, Lagjja e "Muhaxhirëve", rr."Gazmend Zajmi"p.n., me kërkesën 05nr.070/01 – 72633/24 dt.05.06.2024, ka kërkuar nga kjo drejtori, vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit të kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 238890/22 dt.14.06.2023, të përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij vendimi.

Me kërkesë, kërkuari ka prezantuar: Fotokopjen e pa vërtetuar të Vendim të kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 238890/22 dt.14.06.2023.

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të bashkangjitur, konsultimit të dosjes së lëndës, 05nr.350/02 – 238890/22 dt.01.11.2022, dhe të rregullativës ligjore në fuqi, nga aspekti i procedurës së përgjithshme administrative, konstatoi se:

Bazuar në dosjen e lëndës të lartcekur, konstatohet se Vendimi i kushteve ndërtimore, 05nr.350/02 – 238890/22 dt.14.06.2023, ka filluar prodhimin e pasojës juridike nga data e njoftimit të kërkuarit me aktin administrativ, gjegjësisht me dt.22.06.2023, kurse kërkesa për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë është parashtruar me datë 05.06.2024, e që është në brenda afatit dhe në harmoni me pikën 8, të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve.

Bazuar në paragrafin XIV. të Kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 238890/22 dt.14.06.2023, dhe në pikën 8, të nenit 13, të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, ku thuhet se, citojmë "Kushtet ndërtimore të miratuara nga organi kompetent apo nga veprimi i ligjit, parimi heshtja është pranimit

do të jenë të vlefshme për një(1) vit, me mundësi vazhdimi për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor”, konstatohet se kërkuesit kanë plotësuar kushtin për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit të kushteve ndërtimore.

Andaj, bazuar në konstatimet e lartshënuara dhe rregullativën ligjore në fuqi, u konstatua se vazhdimi i afatit të vlefshmërisë është i bazuar dhe ligjor, dhe kjo drejtori të njëjtin vendosi ta vazhdojë edhe për një (1) vit tjetër, përmes këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

I dërgohet: Kërkuesit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës, 05nr.350/02 – 238890/22 dt.01.11.2022 dhe 05nr.070/01 – 72633/24 dt.05.06.2024.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, dhe Sektorit të Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.070/01 – 72633/24 DT.24.06.2024**

Zyrtari,
Ergyn Hajredini,



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi.

